

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Raporte Financiare 3-Mujore Për periudhën e mbyllur më: 31/12/2023

Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 [i ndryshuar] të Bankës së Shqipërisë

PERMBAJTJA:	Faqe
1. Bazat e përgatitjes dhe Përmbledhje e Politikave Kontabël	1 - 6
2. Tregues të rentabilitetit të bankës	7
3. Pozicioni financiar, Pasqyra e të Ardhurave dhe zërat jashtë bilancit të përmbledhura	8 - 9
4. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	10
5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë	11
6. Klasifikimi i portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike (rretheve)	12 - 13
7. Kreditë që u ka kaluar afati & kreditë me probleme sipas shpërndarjes gjeografike	14
8. Klasifikimi i portofolit të kredive sipas tipit të industrisë dhënë rezidentëve (rretheve)	15 - 16
9. Shpenzimet për provigjone sipas sektorëve	17
10. Fondet për provigjone dhe lëvizjet gjatë periudhës	18
11. Aktivët sipas maturimit përfundimtar	19
12. Pasivet sipas maturimit përfundimtar	20
13. Struktura e kapitalit rregullator; Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit: Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional	21

Tiranë, më 29/01/2024

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a ("Banka") është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme.

Bazuar në nenin nr.2 të Statutit të të Bankës, objektivi i Bankës është të veproje, për llogari të vet apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Raiffeisen Bank sh.a. është krijuar dhe themeluar si dhe operon vetëm në Shqipëri.

Raiffeisen Bank sh.a. është shoqëri e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri me 100 % të kapitalit.

Më 31 Dhjetor 2023, Banka operon me një rrjet bankar prej 74 pika shërbimi në të gjithë Shqipërinë (31 dhjetor 2022: 74 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 3 Distrikte. Numri i punonjësve të Bankës më 31 Dhjetor 2023 është 1,300 punonjës (31 dhjetor 2022: 1,275).

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptare ("Lek"), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lek, cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

(ii) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave. Aktivët dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 31 Dhjetor 2023 dhe 31 Dhjetor 2022 (Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Dollari Amerikan (USD)	93.94	107.05
Monedha Europiane (EUR)	103.88	114.23
Paundi Britanik (GBP)	119.47	128.92

3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraaja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë ("Banka Qëndrore").

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.3 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për rënien në vlerë.

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e tregut

Vlera e tregut për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara përcaktohet duke iu referuar çmimeve të ofruara (bid) të kuotuar gjatë mbylljes së bursës në datën e bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së tregut përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër, i cili është i përafërt në natyrë. Vlera e tregut, gjithashtu, mund të bazohet në rrjedhjen e pritshme të parasë, ose mbi bazën neto të aktivitetit për letrën me vlerë në fjalë.

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje të anasjellta të riblerjes) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlogaritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha këto marrëveshje bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.4 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Banka i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Banka dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjionet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjioneve të përgjithshme të njohura në bilancin e Bankës, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer të detyrimit.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja" miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjioneve:

Kategoria e huasë	Provigjioni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjionin për huatë e këqija, shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën individuale të të ardhurave në zërin "Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative".

Banka nuk përlogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbetur e huave, për të cilat nuk përlogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjionin për humbjet e pritshme. Provigjioni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

Politikat e fshirjes së kredive

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të fillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

3.5 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara shprehen me koston historike të blerjes plus rivlerësimet (në rastin e ndërtesave) minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Ndërtesat shprehen me vlerat e rivlerësuar, të cilat janë vlerat reale në bazë të përdorimit aktual në datën e rivlerësimit, minus ndonjë zhvlerësim pasues të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë vijuese të akumuluar. Rezultati i rivlerësimit është paraqitur në rezervat e rivlerësimit.

Zhvlerësimi dhe amortizimi paraqiten si pakësim i kostos së mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim dhe jetëgjatësitë të vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	31 Dhjetor 2023 (në vite)	31 Dhjetor 2022 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Automjete	7	7
• Kompjuterat dhe pajisje informatike	4 deri në 7	4 deri në 7
• Software dhe Licensa	8	8
• Makineri dhe sisteme	7	7
• Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7	5 deri në 7
• Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10	1 deri në 10

Toka dhe punimet në proçes nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën individuale të të ardhurave në periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.6 Pronat e rimarra në zotërim

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, dhe njihen në pasqyrat financiare individuale si "Aktive të tjera". Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

3.7 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.8 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përllogaritjeje.

3.9 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

3.10 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.11 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin më 31 Dhjetor 2023 llogaritet 15% (31 Dhjetor 2022: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.12 Pjesëmarrje në filial

Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Leasing Sh.a. Raiffeisen Leasing Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar sipas vendimit të Gjykatës së Tiranës Nr.35733 të datës 15 Maj 2006 dhe ushtron aktivitetin e qiradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm "Mbi Qiradhënien Financiare".

Banka ka blerë 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Sh.a. Blerja është aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr 30, datë 26 Mars 2009, regjistruar në Qendra Kombëtare e Regjistrimit më 23 Prill 2009.

3.13 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qenë se për instrumentat financiarë të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiare të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Bankës kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrjnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose rriçmohen brenda vitit.

3.14 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

3.15 Krahasueshmëria

Politikat kontabël të adoptuara nga Banka janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

Tregues të rentabilitetit të bankës *

Tregues të rentabilitetit të bankës *	31/12/2023	30/9/2023	30/6/2023	31/3/2023	31/12/2022	30/9/2022	30/6/2022	31/3/2022
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100];	2.57 %	2.40 %	1.58 %	1.97 %	1.5 %	1.5 %	1.4 %	1.0 %
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.0 %	0.1 %	0.0 %	0.1 %	0.1 %
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	24.7 %	25.7 %	26.5 %	29.4 %	29.3 %	30.0 %	32.0 %	33.8 %
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	215.3 %	214 %	208 %	192 %	161 %	157 %	151 %	143 %
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100];	21.85 %	20.10 %	13.33 %	17.00 %	13.1 %	12.4 %	11.4 %	8.0 %
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000;	235,660	230,301	225,080	225,974	224,603	230,458	225,864	222,423
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	4.1 %	4.0 %	2.6 %	3.8 %	2.9 %	2.8 %	2.8 %	2.6 %
8. Marzhi neto nga interesat: [Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare qe sjellin te ardhura]	4.9 %	4.8 %	3.1 %	4.5 %	3.7 %	3.5 %	3.7 %	3.4 %
9. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare;	4.3 %	4.2 %	2.7 %	3.9 %	3.1 %	2.9 %	2.9 %	2.7 %
10. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;	0.2 %	0.2 %	0.1 %	0.2 %	0.2 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	53.1 %	55.0 %	55.1 %	56.4 %	47.1 %	47.2 %	48.2 %	48.2 %
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	1.0 %	1.1 %	0.6 %	0.9 %	1.1 %	1.0 %	1.0 %	0.9 %
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	59.0 %	58.8 %	58.1 %	60.5 %	69.1 %	67.8 %	68.8 %	74.8 %
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	12.3 %	12.8 %	12.9 %	13.3 %	14.6 %	14.8 %	14.9 %	15.4 %
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	0.1 %	0.2 %	0.0 %	0.1 %	0.3 %	0.1 %	0.2 %	0.4 %

(*) Treguesit janë llogaritur sipas kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë (i ndryshuar)

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilancit

Aktiv në mijë Lekë	31/12 2023	31/12 2022	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	41,876,906	37,893,341	3,983,565	10.5%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	28,097,371	9,277,212	18,820,159	202.9%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	32,526,513	40,511,838	-7,985,325	-19.7%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	119,144,359	116,776,265	2,368,094	2.0%
Letra me vlerë	76,667,571	73,925,416	2,742,155	3.7%
Investime në filiale	329,205	329,205	-	0.0%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	-	-	-	0%
Tatim fitimi për t'u arketuar	-	-	-	0%
Mjete të patrupëzuara	2,183,419	2,023,285	160,134	7.9%
Mjete të trupëzuara	3,324,389	3,280,787	43,602	1.3%
Mjete të tjera, neto	2,208,642	2,352,017	-143,376	-6.1%
Totali aktiveve	306,358,374	286,369,366	19,989,008	7.0%

Detyrimet dhe kapitali në mijë Lekë	31/12 2023	31/12 2022	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	-	-	-	0.0%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	-	-	-	-
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	9,367,294	2,902,566	6,464,727	222.7%
Detyrimet ndaj klientëve	251,822,856	242,467,634	9,355,222	3.9%
Detyrimet ndaj qeverisë dhe organizatave publike	354,045	396,293	-42,248	-10.7%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	2,170,713	1,869,240	301,472	16.1%
Fonde rezervë për rrezique dhe shpenzime	1,382,077	1,392,546	-10,470	-0.8%
Borxh i varur	2,106,945	-	2,106,945	-
Tatimi fitimi për t'u paguar	697,055	519,598	177,457	34.2%
Detyrime të tjera	4,320,091	4,128,151	191,940	4.6%
Kapitali aksionar	34,137,299	32,693,337	1,443,962	4.4%
Kapitali i paguar	14,178,593	14,178,593	-	0.0%
Rezerva	4,779,149	4,869,576	-90,427	-1.9%
Diferenca rivilësimi	-3,716,767	-2,710,149	-1,006,617	37.1%
Fitimet e pashpërndara	11,325,424	11,976,090	-650,666	-5.4%
Fitimi i vitit ushtrimor	7,570,901	4,379,229	3,191,672	72.9%
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	306,358,374	286,369,366	19,989,008	7.0%

Zërat jashtë bilancit mijë Lekë	31/12 2023	31/12 2022	Ndryshimi absolut	Ndryshimi ne %
Angazhime dhe garanci të dhëna	30,982,899	30,660,897	322,002	1.1%
Angazhime garanci të marra	714,809	1,940,142	-1,225,333	-63.2%
Transaksione në valutë	5,229,589	12,357,933	-7,128,344	-57.7%
Angazhime të tjera	-	-	-	-

Shënim: Shifrat janë të pa audituara nga auditorët e jashtëm

	31/12 2023	30/09 2023	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	41,876,906	41,296,983	579,923	1.4%
	28,097,371	26,628,787	1,468,583	5.5%
	32,526,513	29,784,806	2,741,707	9.2%
	119,144,359	114,585,262	4,559,097	4.0%
	76,667,571	77,528,907	-861,336	-1.1%
	329,205	329,205	-	0.0%
	-	-	-	0%
	-	-	-	0%
	2,183,419	1,918,286	265,133	13.8%
	3,324,389	3,337,857	-13,468	-0.4%
	2,208,642	2,138,817	69,825	3.3%
Totali	306,358,374	297,548,910	8,809,464	3.0%

	31/12 2023	30/09 2023	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	-	-	-	0.0%
	-	5,087,886	-5,087,886	-
	9,367,294	6,027,284	3,340,010	55.4%
	251,822,856	241,509,976	10,312,880	0.04
	354,045	378,554	-24,509	-0.06
	2,170,713	1,723,999	446,714	25.9%
	1,382,077	1,374,247	7,829	0.6%
	2,106,945	-	2,106,945	-
	697,055	598,272	98,783	0.17
	4,320,091	3,743,582	576,509	15.4%
	34,137,299	37,105,110	-2,967,811	-8.0%
	14,178,593	14,178,593	-	0.0%
	4,779,149	4,801,756	-22,607	-0.5%
	-3,716,767	-3,473,173	-243,594	7.0%
	11,325,424	16,355,319	-5,029,895	-30.8%
	7,570,901	5,242,617	2,328,284	44.4%
Totali	306,358,374	297,548,910	8,809,464	3.0%

	31/12 2023	30/09 2023	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
	30,982,899	33,749,081	-2,766,182	-8.2%
	714,809	721,540	-6,731	-0.9%
	5,229,589	6,458,077	-1,228,487	-19.0%
	-	-	-	-

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

në mijë Lekë	1/1-31/12 2023	1/1-31/12 2022	Ndryshimi vit me vit absolut	Ndryshimi vit me vit ne %	Tremujori-4 2023	Tremujori-3 2023	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Të ardhura nga interesat	9,101,165	6,111,316	2,989,849	48.9%	2,447,922	2,354,429	93,493	4.0%
Shpenzime për interesa	-255,111	-110,391	-144,719	131.1%	-105,592	-70,043	-35,549	50.8%
Te Ardhurat Neto nga Interesat	8,846,054	6,000,924	2,845,130	47.4%	2,342,330	2,284,387	57,943	2.5%
Të ardhura nga operacionet financiare	3,581,641	2,668,231	913,410	34.2%	1,022,468	923,750	98,718	10.7%
Humbje nga operacionet financiare	-324,890	-315,862	-9,028	2.9%	-78,804	-83,867	5,063	-6.0%
Fitimi neto nga veprimet financiare	3,256,751	2,352,369	904,382	38.4%	943,663	839,883	103,781	12.4%
Te ardhurat nga komisionet	4,200,515	4,005,005	195,509	4.9%	1,005,522	1,219,437	-213,915	-17.5%
Shpenzime per komisionet	-1,992,022	-1,642,850	-349,171	21.3%	-550,169	-586,756	36,587	-6.2%
Fitimi Neto nga Komisionet	2,208,493	2,362,155	-153,662	-6.5%	455,354	632,681	-177,328	-28.0%
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	1,123,155	962,656	160,499	16.7%	440,816	274,565	166,251	60.6%
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	4,619	4,956	-336	-6.8%	1,145	1,327	-182	-13.7%
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtaritë e tjera bankare	-404,269	-283,664	-120,605	42.5%	-309,835	102,139	-411,974	-
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare	15,034,803	11,399,396	3,635,407	31.9%	3,873,473	4,134,981	-261,509	-6.3%
Shpenzime për personelin	-2,808,639	-2,589,712	-218,927	8.5%	-760,506	-712,242	-48,264	6.8%
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	-43,298	-45,961	2,664	-5.8%	-2,386	-2,175	-211	9.7%
Shpenzime të përgjithshme administrative	-2,770,331	-2,560,698	-209,633	8.2%	-740,042	-670,425	-69,617	10.4%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	-5,622,268	-5,196,371	-425,897	8.2%	-1,502,934	-1,384,842	-118,092	8.5%
Te ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për amortizime dhe për fonde rezervë	9,412,535	6,203,025	3,209,510	51.7%	2,370,539	2,750,139	-379,600	-13.8%
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	-619,544	-527,885	-91,659	17.4%	-164,463	-159,077	-5,386	3.4%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fondet rezervë statistikore	20,469	-95,990	116,460	-	-1,184	-21,502	20,318	-94.5%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	393,082	400,162	-7,080	-1.8%	531,469	-236,206	767,675	-
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	-526,457	-866,171	339,715	-39.2%	-295,126	-50,117	-245,009	488.9%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde të tjera rezervë	-92,211	-246,091	153,881	-62.5%	76,037	-185,256	261,293	-
Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	170,175	182,352	-12,178	-6.7%	37,443	18,603	18,840	101.3%
Fitimi (Humbja) para tatimit	8,758,050	5,049,401	3,708,649	73.4%	2,554,715	2,116,585	438,130	20.7%
Tatimi mbi fitimin	-1,187,149	-670,172	-516,977	77.1%	-226,431	-306,337	79,906	-26.1%
Fitimi / (Humbja) neto per periudhen	7,570,901	4,379,229	3,191,672	72.9%	2,328,284	1,810,249	518,036	28.6%

Shënim: Shifrat janë të pa audituara nga auditorët e jashtëm

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivlerësimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Kapitali më: 01/01/2023	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,598,738	-2,710,149	11,976,090	4,379,229	32,693,337
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	4,379,229	-4,379,229	0
Kalim ne rezerve ligjore	0	0	0	0	0	0	0	0
Diference Rivlerësimi Kapitali	0	0	0	0	-1,006,617	0	0	-1,006,617
Rezerve rivlerësimi per ndertesat	0	0	0	-90,427	0	0	0	-90,427
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	-5,029,895	0	-5,029,895
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	7,570,901	7,570,901
Kapitali më: 31/12/2023	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,508,311	-3,716,767	11,325,424	7,570,901	34,137,299

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivlerësimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
Kapitali më: 01/01/2022	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,707,350	-2,054,552	11,876,637	3,722,926	32,701,792
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	3,722,926	-3,722,926	0
Kalim ne rezerve ligjore	0	0	0	0	0	0	0	0
Diference Rivlerësimi Kapitali	0	0	0	0	-655,598	0	0	-655,598
Rezerve rivlerësimi per ndertesat	0	0	0	-108,612	0	0	0	-108,612
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	-3,623,474	0	-3,623,474
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	4,379,229	4,379,229
Kapitali më: 31/12/2022	14,178,593	1,852,979	1,417,859	1,598,738	-2,710,149	11,976,090	4,379,229	32,693,337

Pasqyra e rrjedhjes së parashë

në mijë Lekë	1/1-31/12 2023	1/1-31/12 2022
Flukset monetare nga aktiviteti operacional		
1. Fitimi (Humbja) i vitit ushtrimor	7,570,901	4,379,229
2. Zera Jo-Monetar ne pasqyren e rrjedhjes se parase		
Zhvleresimi / amortizimi	709,971	618,312
Mjeteve te qendrueshme nxjerre jashte bilanci	7,691	7,649
Shpenzimet për fondet rezervë	4,019,300	3,552,840
(Transferime nga fondet rezerve)	(4,431,068)	(3,701,346)
(Rritje)/Paksim ne interesat per t'u arketuar	(246,720)	(444,064)
Rritje/(Paksim) ne interesat per t'u paguar	50,837	2,375
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë	(369,390)	(136,022)
Diferenca e rivlerësimit	(1,006,617)	(655,598)
3. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (1+2)	6,304,904	3,623,375
4. Ndryshime ne kapitalin qarkullues		
(Rritje)/Renie ne Bonot e thesarit dhe bonot e tjera te pershtatshme per rifinancim me BSH	1,073,636	109,208
(Rritje)/Renie e te drejtave (aktive) ndaj institucioneve financiare	7,993,904	(5,023,857)
(Rritje)/Renie ne hua dhe paradhanie per klientet	(1,903,033)	(9,453,931)
(Rritje)/Renie ne letrat me vlere te tregtueshme dhe te vendosjes	(135,648)	10,219
(Rritje)/ Renie ne mjetet e tjera	809,684	452,861
Rritje/(Renie) ne detyrime ndaj institucioneve financiare	6,453,591	(3,934,314)
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj klienteve	9,344,867	12,010,632
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj Qeverise dhe Administrates Publike	(42,248)	23,458
Rritje/(Renie) ne detyrimet ndaj te treteve	301,472	21,447
Rritje/(Renie) ne detyrimet e tjera	824,864	155,505
5. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (3+4)	31,025,992	(2,005,397)
6. Pagimi i tatimit mbi te ardhurat	(834,596)	(613,965)
Fluksi monetar neto i përdorur në aktivitetin operacional (5+6)	30,191,396	(2,619,362)
Flukset monetare nga aktiviteti investues		
Shitje/(Blerja) e interesave pjesemarrëse dhe filialeve	-	-
Shitje/(blerje) e letrave me vlere te investimit	(22,392,383)	(1,634,300)
Dividentët e marrë	58,245.00	261,978
(Blerja) e mjeteve te qendrueshme	(929,089)	(1,032,804)
Shitje e mjeteve te qendrueshme	7,691	7,649
7. Rrjedhja e parase nga veprimtarite e investimit	(23,255,536)	-2,397,477
Flukset monetare nga aktiviteti financues		
Dividend i paguar nga fitimi	(5,029,895)	(3,623,474)
Rritje/(Renie) ne borxhin e varur	2,077,600	-
Rritje (Paksim) i kapitalit te paguar	0	(18,185)
8. Rrjedhja e parase nga veprimtarite e financimit	(2,952,295)	-3,641,659
9. (Pakesim)/ Rritje e parase (5+6+7+8)	3,983,565	-8,658,498
10. Arka dhe Banka Qendrore ne fillim te periudhes	37,893,341	46,551,839
11. Arka dhe Banka Qendrore ne fund te periudhes (10+9)	41,876,906	37,893,341

